



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3284_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2967_04_26** i datës 30.04.2026;
- Kundërshtimi i KESCO-s i dt. 08.06.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, lidhur me konsumatorin **H. G.**, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2967_04_26 i datës 30.04.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 30.04.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2967_04_26 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit H. G., me shifër DGJ - 9033440 dhe e ka obliguar KESCO-n, që konsumatorit t'i anuloj korrigjimin financiar të dt. 25.11.2024, dhe për periudhën kohore prej 02-12/2023, ta korrigjoj në vlerë financiare prej **198.32 €**, dhe për këtë korrigjim, t'i ofroj një kontratë pagese për periudhën kohore dhjetë (10) mujore.

Të pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Shpenzimi i regjistruar në njehsorin elektrik me nr. 61096698 është i saktë dhe mos faturimi me rregull i konsumatorit, nuk nënkupton matje jo të saktë të shpenzimit të tij;
- Korrigjimi i kontestuar, është i mbështetur në gjendjet e regjistruara në njehsorin elektrik, sepse njehsori është SMART dhe e bën ruajtjen e të dhënave;
- Çdo shpërndarje tjetër e këtyre kWh, në mënyrë proporcionale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kërkojnë pezullimin e vendimit të DMK-së;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të dt. 08.06.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 30.04.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 16.05.2025, Transaksionet e konsumatorit me shifër DGJ – 9033440, Rrjedhën e energjisë elektrike, Listat e leximit dhe Korrigjimin Financiar të dt. 25.11.2024, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Ekipet e autorizuar të KEDS, me datë 30.11.2023, pas inspektimit të pikës matëse të konsumatorit, kanë hartuar procesverbalin me nr. 2032833 për konsumatorin me shifër DGJ – 9033440, njehsori elektrik me nr. 61096668, me gjendje të shpenzimeve prej TL = 29507 kWh dhe TU = 18763 kWh, dhe në vërejtje të këtij procesverbali është evidentuar si në vijim: “Të bëhet ndërrimi i njehsorit, pasi që është prishur releu i njehsorit”.

Më tej, Bordi e ka analizuar edhe Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 078941 të dt. 09.12.2023, në të cilin, ndër të tjera është evidentuar se, për konsumatorin me shifër DGJ = 9033440, largohet nga matja njehsori me nr. 61096698 me gjendje të shpenzimeve prej TL = 29994 kWh dhe TU = 20724 kWh dhe për matje i vendoset një njehsor i ri, me nr. 87439632 me gjendje të shpenzimeve në TU dhe TL = 0000 kWh. Në vërejtje është evidentuar që bëhet ndërrimi i njehsorit nga mekanik në digjital.

Në këtë kuptim, Bordi i ka analizuar me kujdes edhe Listat e Leximit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Transaksionet dhe ka gjetur se, konsumatori duke filluar nga muaji 02/2023 e deri me 12/2023 në Tarifën e Ulët, është faturuar me 0 kWh shpenzim, pra, njehsori elektrik, për shkak të defektit teknik, shpenzimet e konsumatorit në Tarifën e Ulët, nuk i ka regjistruar në njehsor fare dhe rrjedhimisht, si pasojë e mos regjistrimit të saktë të shpenzimit të konsumatorit, edhe faturat e pranuar nuk kanë qenë të sakta dhe në përputhje me konsumin real të tij, pra kanë qenë më të ulëta se sa në periudhat e tjera.

Më tej, është analizuar edhe Korrigjimi Financiar i dt. 21.11.2024, të bërë nga Departamenti i Faturimit në KESCO, në të cilin ndër të tjera është evidentuar si në vijim: “Faturim i kWh për periudhën 01/2023 – 12/2023 bazuar në leximet Case Code, pasi që konsumatori ka qenë 5 shifror, ndërsa në CCP ka qenë si 6 shifror dhe kWh nuk janë faturuar as gjatë ndërrimit të njehsorit, bazuar në procesin nr. 0780941 i dt. 09.12.2023 A1 = 29994 kWh dhe A2 = 20724 kWh, si dhe Rrjedhën e Energjisë Elektrike”, dhe ka gjetur se, KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. “Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”, por që, sipas vlerësimit të Bordit nuk është i saktë, sepse duke u bazuar në shpenzimet e konsumatorit të regjistruara në njehsorin e ri elektrik, me nr. 87439632, për periudhën 02-12/2023, rezulton që, korrigjimi financiar shtesë, duhet të jetë në vlerë prej **198,32 €**, kjo sepse, edhe leximet në TL me njehsorin e vjetër elektrik janë të sakta.



Duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmuje dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuar nga KESCO si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **H. G.**,
- Arkivit të ZRRE-së